

## Intervistë me albanologun Robert Elsie

### KOSOVA EC NË RRUGËN E PAVARESISË

Albanologu i njohur dhe miku i madh i shqiptarëve, Robert Elsie, këtyre ditëve qëndroi për herë të dytë, pas luftës, në Kosovë. Ai nuk përtoi që për gazetën tonë të japë këtë intervistë, të cilën po e botojmë në mënyrë autentike.

*“DP”:* Zoti Elsie, në Kosovë dhe në mbarë trojet shqiptare njiheni si mik i madh i shqiptarëve. Është hera e dytë që vini në Kosovë, pas luftës. Cilat janë përshtypjet tuaja të para?

Elsie: Në Kosovë isha në muajin korrik dhe në tetor dhe mund të them se përshtypjet e mia, si në korrik, si tash, janë kurajuese. Për herë të parë ndjem se jam në një vend të lirë dhe gëzohem jashtë mase, sidomos kur shoh se njerëzit për herë të parë në jetën e tyre janë të lirë. Këtu, kuptohet, ka shumë vuajtje, ka shumë për t’u bërë, por themelet janë vënë dhe Kosova ec në rrugën e pavarësisë, në rrugën e lirisë totale.

*“DP”:* Jeni njohës i mirë i historisë së letërsisë shqiptare, dmth, jeni autor i një libri shumë voluminoz dhe të përkushtuar, *“Historia e letërsisë shqiptare”*. Cila ka qenë arsye që Ju të keni rrekur hartimit të kësaj vepre?

Elsie: Në fakt, në bibliotekat e botës vërejtja që kishte histori të letërsive të ndryshme, por mungonte ajo për letërsinë shqiptare. Madje, mungonte një informacion, pra nuk kishte fare, fare, fare... qoftë edhe një të dhënë elementare. Kishte histori të censuruar, sikurse ishte ajo e hartuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, por mungonte ajo e vërteta. Unë doja që botës së jashtme t’i prezantoja letërsinë shqiptare të depolitizuar. Ky ishte qëllimi im dhe mendoj se ia kam arritur të shkruaj një histori të mirëfilltë të letërsisë shqiptare. Tashti, kemi një histori tjetër përveç asaj zyrtare. Botimi anglisht në Nju Jork dhe ai shqip në Kosovë flasin se në këtë drejtim kam arritur sukses. Për një kohë të gjatë nuk isha i sigurt se a ka nevojë për një libër të tillë dhe a mos është mëndjemadhësi që një i huaj të shkruajë historinë e letërsisë shqiptare. Kam menduar shumë, por në fund vendosa, duke marrë parasysh që historitë e tjera janë të shtrembëruara ose nuk janë të plota. Thashë më vete pse jo, është vetëm një libër. Dikush tjetër mund të shkruajë një histori tjetër të letërsisë akoma më mirë, lë të ketë disa, jo si përpara një histori zyrtare e letërsisë shqiptare, por disa, sepse kështu plotësohet një pluralizëm historik.

*“DP”:* Çka jeni duke punuar aktualisht në këtë fushë?

Elsie: Tani sapo kam mbaruar një libër, më sakt një dorëshkrim, një leksikon për kulturën popullore. Leksikoni përqëndrohet mbi mitologjinë, figurat e mitologjisë, zakonat popullore, fenë, komunitetet fetare, historinë e islamit, krishterizmit, bektashizmit, tarikatet, shënjtoret, baballarët... një përzierje figurash që kanë hyrë në këtë fjalor. Siç duket titulli do të jetë *Fjalori i Fesë. Mitologjisë dhe Kulturës Popullore Shqiptare*. Mua nuk më ka pëlqyer fjala *Fe* në titull, sepse libri merret më shumë me mitologjinë, sesa me fenë, por botuesi në Londër tha se kishte nevojë për fjalën *Fe*, pra religjion, në titull për të shitur librin, kështu që pranova, duke shtuar në titull trajtën kulturore popullore.

Më duket se ka shumë gjëra të reja për kulturën shqiptare, që nuk kanë dalë në botën e jashtme. Kuptohet se shqiptarët vetë dinë shumë për kulturën e tyre, veçanërisht këtu në Kosovë,

e në Maqedoni, sepse kultura e vjetër tradicionale është shumë e pasur. Unë kam kërkuar më shumë në Shqipëri, por pashë se atje kishin humbur të gjitha figurat mitologjike, veçanërisht feja e atyre nuk përfilltet. Burimin e mirëfilltë e gjeta në Kosovë. Këtu njerëzit dinë akoma për traditat e tyre të vjetra, për bestytnitë, për figurat mitologjike, për fëtë e tyre dhe kam hetuar se Kosova dhe Maqedonia Perëndimore është një burim shumë i pasur.

*“DP”:* Cili do të ishte mesazhi i një miku, i një ambasadori të prezantimit të letërsisë shqiptare në botë, për të rinjtë dhe mbarë popullin e Kosovës?

Elsie: Unë them që ka shumë, shumë, shumë për t’u bërë. Shqiptarët ishin një popull i panjohur sa duhet deri para dy vjetësh. Tani janë të njohur, qoftë për shkak të situatës politike në Shqipëri, qoftë për shkak të luftës në Kosovë. Vëmendja u përqëndrua krejtësisht në Kosovë për disa muaj. Bota ngadalë, ngadalë do ta njohë edhe kulturën shqiptare, por ka edhe shumë për t’u berë, ka shumë për t’u botuar, ka shumë për t’u përkthyer në radhë të parë, në mënyrë që kjo kulturë të mos mbetet e panjohur.

*“DP”:* Kur do t’iu shohim sërish në Prishtinë?

Elsie: Sa më herët. Unë kam shumë dëshirë të vijë në Kosovë, shpesh. Deri tash ka patur shumë vështirësi. Kam dëgjuar se linjat ajrore do të fillojnë së shpejti, kështu që nuk jam i detyruar në vijë me një avion të Fondit Botëror të Ushqimit nga Roma, por mund të vijë me një avion të rregullt dhe pa kaluar nëpër Beograd. Kjo më gëzon në mënyrë të posaçme.

Intervistoi: Shaqir Foniqi

[Botuar në: *Dardania Press*, Prishtinë, viti I, nr 101, 9 Nëntor 1999, f. 7]